

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6529
E hënë, 7 shkurt 2022
çmimi 0.40

Deputetët gjermanë konfirmojnë përkrahjen për Kosovën

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KËRKOHET HEQJA E ORËS POLICORE



Asociacioni i Komunave i Kosovës vazhdon të mos pajtohet me disa masa kundër Covidit. Drejtori i këtij asociacioni, Sazan Ibrahim, ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që të hiqet tërësisht ora policore. Sipas tij, kjo masë nuk po tregon asnjë efekt në luftimin e pandemisë. Me masat e reja ora policore do të jetë nga ora 24:00 deri në orën 5:00 të mëngjesit

GAP-i: NJË NUMËR I KONSIDERUESHËM I PROJEKTEVE KAPITALE NUK JANË FUNKSIONALIZUAR NË NIVELIN LOKAL



DISLOKOHEN TRUPA NË AFËRSI TË KUFIRIT MIDIS BJELLORUSISË DHE UKRAINËS

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



DEPUTETI SHALA: QEVERIA PO I
BËN PRESION ZRRE-SË QË TA RRISE
ÇMIMIN E ENERGJISË F. 3

BARRIERAVE ME SHOQPËRINË PO U
VJEN FUNDI F. 6

TURIZMI NË KOSOVË, DIMRI SJELL
ÇDO VIT RRETH 100 MIJË VIZITORE
NGA SHOQPËRIA F. 7



EKONOMI



ATA QË S'MUND TA BLEJNË ARIN,
E NDËRROJNË F. 7

SPORT



FITORE E LEHTË PËR YLLIN,
'BARDHEKALTRIT' MPOSTHIN
'VRESHTARËT' F. 11

Dislokohen trupa në afërsi të kufirit midis Bjellorusisë dhe Ukrainës

MINSK, 6 SHKURT - Imazhet satelitore të publikuara të dielën nga një kompani private amerikane shfaqën detaje mbi manovrat ushtarake në kufirin e Bjellorusisë me Ukrainën para stërvitjeve të përbashkëta ushtarake midis Moskës dhe Minskut. NATO ka thënë se ky është dislokimi më i madh në Bjellorusi që prej Luftës së Ftohtë.

Rusia dhe Bjellorusia kanë thënë se do të mbajnë stërvitje të përbashkëta ushtarake nga 10 shkurti deri më 20 shkurt, që kanë për qëllim trajnimet për të zbrapsur një sulm të mundshëm në kufijtë jugorë të aleancës së tyre. Rusia, po ashtu, ka dhënë disa detaje të raketave dhe avionëve luftarakë që po dërgon për këto stërvitje.

Dislokimi i ri dhe stërvitjet e planifikuara po ndodhin në kohën kur tensionet janë të larta midis Ruisë dhe

Perëndimit për shkak të grumbullimit masiv të forcave ruse në kufi me Ukrainën. Shtetet perëndimore e kanë akuzuar Rusinë se po përgatitet që ta pushtojë Ukrainën, ndërkaq Moska ka mohuar se ka plane të tilla.

Imazhet e publikuara nga kompania me seli në ShBA, Maxar Technologies, shfaqën njësitë ushtarake të pajisura me raketa, raketahedhës dhe avionë sulmues të dislokuar në Bjellorusi në tri lokacione pranë kufirit që ky shtet ndan me Ukrainën.

Agjencia e lajmeve "Reuters" nuk ka arritur që të marrë përgjigje nga Ministria e Mbrojtjes e Ruisë dhe as nga zyrtarët ushtarakë bjellorusë lidhur me dislokimin e trupave. Maxar Technologies tha se ka mbledhur imazhe të pajisjeve ushtarake pranë Yelsk, Rechitsa dhe



Luninets, më 4 shkurt. Të gjitha këto lokacione janë rreth 50 kilometra larg kufirit me Ukrainën.

Maxar Technologies tha se në këto imazhe satelitore janë identifikuar 15 avionë sulmues tokësorë të tipit Su-25. Në aeroportin në Luninets është parë edhe sistemi i mbrojtjes ajrore S-400 dhe në afërsi të Yelsk

janë fotografuar raketat SS26 Iskander dhe raketahedhës.

Të shtunën Ministria e Mbrojtjes e Ruisë tha se ka dërguar sistemet S-400 dhe avionët Su-25 për të marrë pjesë në stërvitjet e përbashkëta. Para se të mbahen këto stërvitje, ministri rus i Mbrojtjes, Sergei Shoigu, ka vizituar të

enjten një poligon qitjeje në perëndim të Bjellorusisë.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë javën e kaluar se manovrat në Bjellorusi janë dislokimi më i madh rus në këtë zonë që prej Luftës së Ftohtë dhe ka shtuar se edhe raketat Iskander, që kanë aftësi bërthamore, janë pjesë e këtij dislokimi.

Zvicra kërkon bisedime të reja me BE-në për përmirësimin e raporteve

BERN, 6 SHKURT - Presidenti i Zvicrës, Ignazio Cassis, dëshiron t'i përmirësojë raportet me Bashkimin Evropian dhe kërkoi një paketë të re marrëveshesh dypalëshe. Ai tha se beson që vendi i tij duhet të afrohet më pranë bllokut evropian. Vite bisedimesh që kishin për qëllim ta afronin Zvicrën më pranë tregut të përbashkët të BE-së dështuan në majin e vitit të kaluar, kur qeveria zvicerane hoqi dorë nga një draft-traktat i vitit 2018 që kishte për qëllim t'i forconte lidhjet me partnerin kryesor tregtar. Brukseli për një dekadë po



tenton që ta shtyjë përpara këtë traktat në mënyrë që Zvicra t'i miratojë rregullat e tregut të përbashkët të bllokut. Po ashtu,

ky traktat besohet se mund të ofronte një zgjidhje efektive të një sërë mosmarrëveshjesh. Cassis, i cili, po ashtu, mban

postin e ministrit të Jashtëm, tha se qeveria zvicerane tani po punon për bisedime të reja me BE-në. "Në Këshillin Federal ne aktualisht jemi në proces të definimit të kornizës për një paketë të mundshme apo për një agjendë bisedimesh", tha ai të dielën për gazetën SonntagsZeitung.

Cassis përmendi si tema energjinë dhe elektricitetin për marrëveshje të mundshme dhe shtoi se ka "shumë mundësi për bashkëpunim në fushën e shëndetësisë, kërkimeve, medie, kulturës, përmes të cilave ne mund të thellojmë raportet".

Lidhjet ekonomike midis BE-së dhe Zvicrës tani mbikëqyren nga mbi 100 marrëveshje dypalëshe që datojnë nga viti 1972. Ato marrëveshje janë ende në fuqi, por ato mund të prishen me kalimin e kohës dhe mund ta rrezikojnë anëtarësimin e Zvicrës në tregun e përbashkët evropian.

Cassis tha se në një botë trepalëshe të Shteteve të Bashkuara, Ruisë/Kinës dhe BE-së, "presioni ndaj Zvicrës për të kultivuar raporte më të thella me Evropën do të rritet. Sepse BE-ja është më afër nesh ekonomikisht dhe ideologjikisht".

Erdogani infektohet me koronavirus

ANKARA, 6 SHKURT - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka njoftuar më 5 shkurt se ka dalë pozitiv pas testimit të bërë për Covid-19. Ai ka treguar se nuk ka simptoma të rënda të sëmundjes. "Pas disa simptomave të lehta, unë

dhe gruaja ime dolëm pozitivë për Covid-19. Fatmirësisht, ne kemi infektim të lehtë dhe kuptuam se jemi të infektuar me variantin Omicron të koronavirusit", ka shkruar Erdogan në rrjetin social "Twitter".

Presidenti turk shtoi se do ta vazhdojë punën nga shtëpia.

Autoritetet shëndetësore në Turqi kanë thënë se pothuajse të gjitha rastet e reja me koronavirus në këtë shtet janë me variantin shumë ngjites Omicron.



Deputetët gjermanë konfirmojnë përkrahjen për Kosovën

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur në takim deputetët e parlamentit gjerman, Christian Petry, nga Partia Social Demokrate SPD dhe Boris Mijatovic, nga Partia e Gjellbër.

Deputeti Petry falënderoi kryeministrin për takimin. Ai theksoi që është i gëzuar që Kosova është rreshtuar me shtetet që shkojnë drejt Bashkimit Evropian. Si socialdemokrat, Petry tha se ka pasur dëshirë që ta urojë edhe personalisht kryeministrin Kurti për qeverinë e re nën udhëheqjen e tij.

Kryeministri Kurti e falënderoi Petryn për mbështetjen e tij të vazhdueshme që nga viti 2019, kur u njoftuan gjatë një loje futbollit në Berlin, e cila u zhvillua mes shoqatës Dardania Bamberg dhe Klubit të Futbollit

të Bundestagut. Ndërsa deputeti Mijatovic, kryeministri ia uroi mandatin e parë në parlamentin gjerman. Deputetët u interesuan për situatën aktuale si dhe për marrëdhëniet bilaterale me shtetet fqinje. Kryeministri Kurti theksoi se shpreson që kancelari Scholz e rikthen Procesin e Berlinit në vëmendje të aktorëve në Bashkimin Evropian.

Deputeti Mijatovic theksoi rëndësinë e faktit që në marrëveshjen e koalicionit të qeverisë gjermane është i theksuar integriteti territorial i Bosnjës dhe se kjo vlen për tërë rajonin.

Në takim u diskutua mbi situatën me Covid-19 dhe masat e reja mbrojtëse.

Kryeministri Kurti i njoftoi që mbi 60 për qind të popullatës mbi 16 vjeç tashmë janë të vaksinuar, ndërsa po vazhdon vaksinimi edhe me dozën përfunduese.



Kryeministri Kurti theksoi përkushtimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për zhvillim ekonomik, reformë të drejtësisë dhe qeverisje të mirë. Ai i njoftoi se, sipas Bankës Qendrore të Kosovës, rritja ekonomike është 9.9 për qind, e që përbën rritjen më të madhe ekonomike që nga shpallja e pavarësisë. "Buxheti i vitit 2022

është buxheti më i madh ndonjëherë në Republikën e Kosovës, me një rritje prej 12-përqindësh krahasuar me buxhetin e vitit të kaluar. Bazuar në indikatorët ekonomikë, ekonomia vendore po përformon mirë, me rritjen e të hyrave doganore për mbi 1/3 krahasuar me vitin paraprak. Ndërsa eksportet janë rritur 66

për qind, të hyrat buxhetore janë rritur 30 për qind, e investimet e huaja 53 për qind", ka deklaruar Kurti.

Në fund të takimit, deputetët gjermanë theksuan që politikëbërja gjermane do të ketë vëmendje të shtuar për Kosovën dhe rajonin, si dhe premtuan mbështetjen e tyre për objektivat e përbashkëta.

Deputeti Shala: Qeveria po i bën presion ZRRE-së që ta rrisë çmimin e energjisë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 6 SHKURT - Kryetari i Komisionit për Ekonomi dhe deputeti i PDK-së, Ferat Shala, ka thënë se vendimi i fundit i Qeverisë së Kosovës për rritjen e shumës për mbështetjen e sektorit të energjisë nga 75 milionë euro në 90 milionë euro është vërejtja e fundit për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) që të procedojë rritjen e tarifave për çmimin e energjisë. Ai ka thënë se me këtë vendim ZRRE-ja po vihet edhe një herë para presionit të Qeverisë së Kosovës për rritje të domosdoshme të çmimit të energjisë.

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e 60 të saj, ka miratuar vendimin për zotim për subvencionim të energjisë elektrike në shumën prej 90 milionë eurosh. "Vendimi

i fundit i Qeverisë së Kosovës për rritjen e shumës për mbështetjen e sektorit të energjisë nga 75 milionë euro në 90 milionë euro, në fakt, është vërejtja e fundit për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), që të procedojë me rritjen e tarifave për çmimin e energjisë. Pra me këtë vendim ZRRE-ja po vihet edhe një herë para presionit të Qeverisë së Kosovës për rritje të domosdoshme të çmimit të energjisë. Fatkeqësisht, pre e këtyre manipulimeve dhe vendimeve të paarsyeshme do të jenë qytetarët (konsumatorët), të cilët që nga muaji shkurt do t'i presin faturat me rritje, të cilat do të jenë të papërbalueshme për buxhetin e varfër të tyre", ka shkruar Shala në llogarinë e vet në "Facebook".

Kryetari i Rahovecit i bashkohet nismës vullnetare për dhurimin e gjakut

RAHOVEC, 6 SHKURT - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, i është bashkuar nismës vullnetare për dhurimin e gjakut. "Edhe sivjet iu bashkova nismës vullnetare për dhurimin e gjakut që po mbahet në Ratkoc për të katërmbëdhjetin vit me radhë. Bashkëfshatarët e mi nga Ratkoci, por edhe qytetarë nga Rahoveci e fshatra të tjerë, po i

përgjigjen pozitivisht kësaj nisme, që sivjet u dedikohet atyre që humbën jetën në përballje me virusin vdekjeprurës Covid-19", ka shkruar Latifi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka thënë se dhurimi i gjakut është një prej veprave më humane që mund ta bëjë secili prej nesh për të shpëtuar jetën e njerëzve me probleme

shëndetësore. "Përveç të tjerash, është dëshmuar tanimë se dhurimi i gjakut ka përfitime shëndetësore edhe për dhuruesit. Falënderoj Këshillin Organizues të kësaj nisme për organizimin e shkëlqyeshëm dhe inkurajoj të gjithë qytetarët e Rahovecit që t'u bashkohen dhuruesve të shumtë të gjakut në Ratkoc", ka shkruar Latifi.





Kërkohet heqja e orës policore

Asociacioni i Komunave i Kosovës vazhdon të mos pajtohet me disa masa kundër Covidit. Drejtori i këtij asociacioni, Sazan Ibrahim, ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që të hiqet tërësisht ora policore. Sipas tij, kjo masë nuk po tregon asnjë efekt në luftimin e pandemisë. Me masat e reja ora policore do të jetë nga ora 24:00 deri në orën 5:00 të mëngjesit

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 6 SHKURT - Asociacioni i Komunave të Kosovës ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që të hiqet ora policore. Drejtori i këtij asociacioni, Sazan Ibrahim, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se kjo masë nuk ka asnjë efekt për pengimin e përhapjes së koronavirusit. Sipas tij, kjo masë po pengon vetëm qytetarët dhe bizneset. "Kemi vlerësuar se masa e orës policore nuk dha ndonjë efekt, nuk ka ndonjë argument shkencor se pse duhet të jetë, sepse po shihet se masa e orës

policore ka qenë edhe në tetor kur kemi pasur numrin e të infektuarve minimal njëshifror, por edhe kur i patëm 4 000 raste në ditë dhe tash i kemi 1 000 deri në 2 000 raste. Po shihet se një masë e tillë nuk ka dhënë ndonjë efekt dhe nuk ka ndonjë argument shkencor ku tregohet që intensiteti i virusit është më i shtuar natën sesa gjatë ditës", ka deklaruar Ibrahim.

Ai ka bërë me dije se qeveria është duke injoruar kërkesat e këtij institucioni. Sipas Ibrahimit, ministri i ri i Shëndetësisë ende nuk e ka ftuar asociacionin në takimet e komitetit për menaxhimin e situatës me Covid. "Masat për

parandalimin e përhapjes së Covid-19 duhet të jenë proporcionale me situatën në terren. Për këtë arsye kemi kërkuar që të kemi konsultime me nivelin qendror, konsultime këto të cilat nuk janë duke ndodhur që nga tetori i vitit të kaluar, dhe me ardhjen e ministrit të ri arsyeja nuk dihet, mirëpo rekomandimet e Asociacionit të Komunave të Kosovës të bazuara në eksperiencat rajonale dhe evropiane duhet të merren parasysh, sepse as Republika e Kosovës, as mekanizmat e tjerë ndërinstucionalë nuk po zbulojnë diçka të re, mirëpo bazohen në praktika të cilat vijnë nga shtetet në rajon", ka deklaruar ai.

Gjashtë të vdekur nga koronavirusi

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë raportuar 6 raste të vdekjes. Sipas MSh-së, gjatë kësaj periudhe kohore janë raportuar 1 283 qytetarë pozitivë me virusin. "Nga 6 696

testime, 1 283 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar 6 raste të vdekjes. Sot janë shënuar 4 397 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 187 508. Në total numri i rasteve aktive është 26 977", është thënë në njoftimin e ministrisë.

Ministria e Shëndetësisë ka treguar edhe për dozat e vaksinës që janë dhënë në 24 orët e fundit. "Në 24 orët e fundit janë dhënë 1 239 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 792 775 doza të vaksinës. Deri më sot 808 218 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 88 718 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19", është thënë në njoftimin e ministrisë.

IKShPK-ja u ka bërë thirrje qytetarëve për kujdes dhe respektim të masave kundër Covidit. Sipas këtij instituti, Omicroni po vazhdon të përhapet me intensitet të lartë,

me shtim të hospitalizimeve dhe rasteve fatale dhe është varianti dominues në qarkullim që po rëndon gjithnjë e më tepër situatën epidemiologjike. "Situata epidemiologjike mund të përkeqësohet edhe më shumë ditët në vazhdim, andaj IKShPK apelon te të gjithë qytetarët që të respektohen masat e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Na ndihmoni që t'ju ndihmojmë! Për shkak të rrezikshmërisë së lartë të përhapjes së Covid-19, bëjmë thirrje në veçanti për kujdes dhe mosgrumbullim. Ndërsa rekomandojmë institucionet përgjegjëse të mbikëqyrin me përpikëri dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e masave për parandalimin dhe luftimin e pandemisë", ka njoftuar IKShPK-ja.

Hyjnë në fuqi masat e reja

Qeveria e Kosovës ka marrë vendim të premtën për lehtësimin e masave kundër Covid-19 të cilat kanë hyrë në

GAP-i: Një numër i konsiderueshëm i projekteve kapitale nuk janë funksionalizuar në nivelin lokal

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 SHKURT - Të dielën Instituti GAP ka publikuar raportin "Qëndrueshmëria e investimeve kapitale të komunave". Në nivel komunal, një numër i konsiderueshëm i projekteve kapitale nuk janë funksionalizuar asnjëherë apo nuk kanë arritur rezultatin e planifikuar. Përkundër nevojës së lartë për investime, janë shpenzuar miliona euro të taksapaguesve për ndërtimin e objekteve të ndryshme të cilat

nuk janë shfrytëzuar. Në disa raste objektet e ndërtuara janë dëmtuar nga mosshfrytëzimi i tyre.

Raporti i Institutit GAP ofron shembuj të investimeve të kryera që nga viti 2000 të cilat ende nuk janë funksionale. Ndërsa raste të tjera përfshijnë ndërtimin e shkollave, që pas përfundimit të ndërtimit është konstatuar që terreni është jo i përshtatshëm për ardhje/vajtje të nxënësve, ose ndërtimin e qendrave mjekësore për të cilat pas përfundimit është konstatuar

që nuk ka numër të mjekëve për t'i bërë ato funksionale, e deri te ndërtimi i kontejnerëve nëntokësorë për mbeturina, që vetëm pas ndërtimit është konstatuar që Kosovës i mungojnë automjetet adekuate për tërheqjen e mbeturinave në sistemin nëntokësor.

Këto raste, përveç që dëshmojnë mosplanifikim të duhur të investimeve, janë edhe rezultat i ndryshimeve demografike dhe rrjedhimisht, mungesa e nevojës për shfrytëzimin e tyre;

mosmirëmbajtja dhe dëmtimi i projekteve pas përfundimit të investimeve;

kontestet pronësore; mungesa e fondeve të mjaftueshme për të përfunduar projektin dhe në disa raste pamundësia e komunave për të pranuar staf me pagesë të rregullt, në menaxhimin ose funksionimin e objekteve të caktuara.

Instituti GAP ka analizuar shkaqet që çuan në dështimin e disa projekteve kapitale në të kaluarën, në mënyrë që të nxirren mësim nga këto projekte. Sipas këtij raporti,

arsyet që mund të dërgojnë në investime kapitale të dështuara në njërin anë ndërlidhen me mospërfshirjen e mjaftueshme të grupeve të interesit gjatë fazave të projekteve, në anën tjetër me mosrespektimin e plotë të procedurave ligjore të prokurimit, duke filluar nga hartimi i kontratave me operatorët ekonomikë dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre. GAP-i ka ofruar edhe një numër rekomandimesh se si do të mund të përmirësohen politikat publike në këtë fushë.



fuqi të shtunën. Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka deklaruar se masat kanë qenë të efektshme në luftimin e pandemisë. "Kemi vendosur lehtësimin gradual të masave që mundësojnë një aktivitet të

shtuar ekonomik, njëkohësisht synojmë ta ngadalësojnë infektimin", ka thënë Latifi në konferencë për medie.

Me masat e reja personat që hyjnë në Kosovë duhet ta kenë certifikatën e vaksinimit të

plotë me dy doza, ose vaksinimin me një dozë së bashku me një test negativ PCR. Sipas masave të miratuara, bartja e maskës duke mbuluar hundën dhe gojën është e obligueshme në të gjitha rastet

në ambientet e mbyllura. Sa i përket kufizimit të lëvizjes, orë policore do të ketë nga ora 24:00 deri në orën 5:00 të mëngjesit. Shërbimet e gastronomisë lejohet ta zhvillojnë aktivitetin e tyre nga

ora 05:00 deri në orën 23:00, ndërsa muzika lejohet vetëm deri në orën 22:00.

Qeveria, po ashtu, ka lejuar punën e palestrave që u ishte ndaluar puna me masat e deritashme.

Barrierave me Shqipërinë po u vjen fundi

PRISHTINË, 6 SHKURT - Thjeshtësimi i procedurave doganore midis Kosovës dhe Shqipërisë, zvogëlimi i pritjes në pikat kufitare dhe vendosja e zyrës doganore të Kosovës në Portin e Durrësit janë disa lehtësira

tregtare midis këtyre dy vendeve që shpejt pritet të marrin karakter ligjor. Qeveria e Kosovës ka miratuar më 26 janar Projektligjin për zbatimin e lehtësirave doganore dhe kontrollin e hyrjes dhe

daljes së mallrave. E njëjta masë është miratuar edhe nga Qeveria e Shqipërisë. Ajo rrjedh nga marrëveshjet që dy vendet kanë nënshkruar në mbledhjen e përbashkët të qeverive të mbajtur më 26

nëntor të vitit të kaluar në Elbasan. Brenda ditësh projektligji pritet të dalë për miratim edhe në Kuvendin e Kosovës. “Më 27 janar ky projektligj është proceduar në Kuvend, më 28 [janar] e

kemi shpërndarë te deputetët. I ka dy javë që të shkojë në seancë”, konfirmon për “Radion Evropa e Lirë”, Ismet Krasniqi, sekretar i përgjithshëm në Kuvendin e Kosovës.

Ankesat e bizneseve për barrierë

Përfaqësues të bizneseve në Kosovë për vite me radhë janë ankuar se Shqipëria u vendos barrierë tregtare kur produktet e tyre i eksportojnë në këtë vend, ose kur Shqipërinë e përdorin si kalim transitit për të eksportuar në vendet e Bashkimit Evropian. Për një kalim transitit në territorin e Shqipërisë, fabrika e këpucëve “Solid” nga Kosova paguan afër 80 euro, thotë Shpejtimit Kuqi, drejtor i kompanisë. “Shqipëria nuk e njeh transitin që bëhet në Kosovë, kërkon të bëhet edhe një transit në Kukës dhe një skanim i mallrave në Durrës. Kjo merr kohë dhe është e kushtueshme”, thotë ai.

Përsheptimi i procedurave të transitit, po ashtu, është një nga pikat e marrëveshjeve për lehtësira tregtare të arritura midis Kosovës dhe Shqipërisë. Në uebfaqen e Doganave të Shqipërisë thuhet se tashmë ka një sistem të përbashkët të transitit. Ky sistem thuhet se “u mundëson bizneseve nisjen e një procedure transitit në territorin e Shqipërisë apo të Kosovës” dhe “mbylljen e transitit në vendin tjetër (Kosovë apo Shqipëri), duke shmangur kontrollet e panevojshme kufitare”. Sipas Kuqit, ky sistem nuk

zbatohet në praktikë. Bizneset në Kosovë janë ankuar edhe për dokumentacione shtesë sanitare dhe fitosanitare në Shqipëri, për mosnjohje të certifikatës së origjinës së produkteve të prodhuara në Kosovë, për tarifa të larta rrugore e të tjera. Por, probleme të ngjashme kanë raportuar edhe bizneset nga Shqipëria që eksportojnë në Kosovë. Për eliminimin e barrierave të tilla tregtare, Kosova dhe Shqipëria ndër vite kanë nënshkruar dhjetëra marrëveshje. Mbi 90 të tilla që kanë në fokus përmirësimin e shkëmbimeve

tregtare janë nënshkruar në tetë vjetët e kaluar, por shumë herë nuk kanë gjetur zbatim. Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se me miratimin e projektligjeve për lehtësira tregtare, është afër mundësia që barrierave midis dy shteteve t’u vijë fundi. “Aprovimi i këtyre projektligjeve mundëson ratifikimin e marrëveshjeve dhe këto barrierë tregtare mes dy shteteve nuk do të kenë më bazë ligjore për të ekzistuar”, thotë Zeka. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe ai i Shqipërisë, Edi

Rama, në mbledhjen e fundit të qeverive të tyre, kanë premtuar se do t’i eliminojnë të gjitha barrierat tregtare që kanë bizneset e dy shteteve. Ndër vite, Kosova dhe Shqipëria kanë investuar miliarda euro në infrastrukturën rrugore që i lidh ato. Vlera e produkteve të shkëmbyera midis dy vendeve dallon. Në vitin 2020 Shqipëria ka eksportuar në Kosovë mallra në vlerë rreth 200 milionë euro, ndërsa Kosova në Shqipëri mallra në vlerë mbi 110 milionë euro. Të dhënat për vitin 2021 nuk janë publikuar ende.



SBASHK-u pret rritje të pagave me Ligjin e Pagave

PRISHTINË, 6 SHKURT - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) pret që me Ligjin e ri të Pagave të ketë rritje të pagave për punëtorët e arsimit. Ndryshe nga deklaratimet e zëvendësministrit të Arsimit, Dukagjin Pupovci, që ditë më parë tha se ligji nuk do të thotë rritje automatike e pagave, në SBASHK thonë se nuk

tërhiqen nga kërkesa e tyre. Nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala, në një intervistë për “KosovaPress”, ka thënë se pritshmëritë e tyre është se mesimdhënësit të jenë ndër më të paguarit në mesin e punëtorëve të administratës shtetërore. “Ne presim në këtë ligj të pagave që është duke u punuar, natyrisht që do të ketë edhe ngritje të pagave ngaqë tani nuk mund t’i



qasemi ligjit të mëparshëm, pasi që Kushtetuesja e ka anuluar atë ligj. Nga

projektligji i ri i pagave kërkojmë që punëtorët e arsimit, duke filluar nga

çerdhet e deri në universitet, të jenë të ranguar me koeficiente diku nga mesi i të gjithë koeficienteve të mundshëm që do të jenë në këtë projektligj të pagave, dhe natyrisht kërkesë jonë është që me ligjin e ri të pagave të ketë edhe ngritje të pagave për të gjithë punëtorët e arsimit, duke filluar nga çerdhet e deri në universitet”, ka deklaruar ajo.

Ata që s'mund ta blejnë arin, e ndërrojnë

PRISHTINË, 6 SHKURT - Rritja e çmimit të arit ka ulur kërkesën për këtë mall në tregun e Kosovës, por ka rritur interesimin për ndërrim të tij me vlerën e njëjtë.

Pronarë të argjendarive thonë se qytetarët zakonisht i ndërrojnë modelet e vjetra të arit me modele të reja.

Enver Pakashtica, kryetar i Shoqatës së Artarëve të Kosovës, thotë se gjatë vitit 2021 çmimi i arit është rritur në 51 mijë euro për kilogram, nga 47 mijë euro sa ka qenë në vitin 2020.

Çmimi i arit varet nga lëvizjet në bursën ndërkombëtare.

Pakashtica thotë se interesimi për të blerë ar ka rënë shumë që nga shpërthimi i pandemisë së koronavirusit në mars të vitit 2020. "Viti 2020 ka qenë shumë i rëndë, më 2021 ka pasur lëvizje pozitive, por jo në nivel të kënaqshëm.

Zakonisht, qytetarët blejnë ar për dasma. Diaspora blen më shumë. Tash, pasi nuk ka dasma, vjen ndonjë qytetar për ndonjë datëlindje, festë, dhuratë, por jo blerje nga dëshira", thotë Pakashtica. Sipas tij, trend është ndërrimi i arit, "rreth 80 për qind e konsumatorëve janë të kësaj kategorie", thekson ai.

Vitin e kaluar, gjatë një pjese të madhe të muajve të verës, në Kosovë është lejuar organizimi i

ahengjeve dhe dasmave, pasi situata me koronavirus ka qenë më e qetë.

Në këto tubime është traditë që gratë të vendosin më shumë ar, qoftë vathë, unaza, byzlykë dhe aksesori të tjerë.

Gjatë vitit 2020 masat kundër koronavirusit kanë qenë më të ashpra dhe organizimi i ahengjeve dhe dasmave nuk është lejuar, ndërsa Kosovën e ka vizituar edhe numër më i vogël i qytetarëve nga diaspora sesa zakonisht.

Por, me lehtësimin e masave në fillim të vitit të kaluar, pronarët e argjendarive thonë se janë furnizuar me sasi më të mëdha të arit.

Edhe të dhënat zyrtare tregojnë se në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2021 ka pasur rritje të importit të këtij metali.

Nga janari deri në gusht të vitit 2021 janë importuar mbi 72 kilogramë metale të çmuara, apo rreth 40 kilogramë më shumë se në vitin paraprak.

Në vitin 2020 janë importuar rreth 33 kilogramë; më 2019, 45 kilogramë; më 2018, 56 kilogramë dhe më 2017, 44 kilogramë ar.

Xhemajl Bajrami, pronar i argjendarisë "Eti Gold" në Gjilan, thotë se gjendja ekonomike e qytetarëve e ka zbehur interesimin e tyre për



metale të çmuara. "Një lirë kushton 350 euro, kurse rroga mujore është 300 euro. Me çka të blihet? Pesë për qind e shoqërisë - biznesmenë - mund të them se blejnë ar për qejf. Pjesa tjetër, shumë pak. Edhe stolitë për çiftet e martuara janë anashkaluar", thotë Bajrami.

Paga mesatare bruto në Kosovë llogaritet të jetë rreth 460 euro. Paga mesatare bruto në sektorin publik është rreth 620 euro, ndërsa në sektorin privat rreth 380 euro.

Disa qytetarë të anketuar nga Radio Evropa e Lirë në Prishtinë shprehin dëshirën për të blerë ar, por thonë se mundësitë e tyre financiare janë të kufizuara.

Shemsije Rrahmani, laborante në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, thotë se i pëlqen ky produkt dhe se blen vetëm për ndonjë festë të caktuar. "Blej ar, por jo shpesh, sepse është shtrenjtë. Ia vlen të kesh ar, sepse asnjëherë nuk e humb vlerën", thotë ajo.

Kumrija nga Danimarka thotë se sa herë që viziton Kosovën për pushime, blen edhe ar. "Thjesht, më pëlqen shumë. Kam lloje të ndryshme të stolive, unaza, vathë, byzlykë. Blej shumë për vete dhe për anëtarë të familjes. Është shtrenjtë, por ari mund të konsiderohet si para e kursyer", thotë Kumrija.

Ndryshe prej tyre, Besart Elshani

thotë se nuk i pëlqen ari dhe se nuk është interesuar për çmimin. "Përdorimi dhe blerja e arit janë më shumë çështje merak. Pavarësisht prej shpenzimeve ose koston, ka qytetarë që e blejnë. Unë, personalisht, as nuk e përdor dhe as nuk e blej, as nuk i di çmimet", thotë ai.

Me gjithë interesimin e qytetarëve, Kosova është shteti i vetëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor që nuk ka rezerva të arit.

Banka Qendrore e Kosovës ka konfirmuar për Radion Evropa e Lirë se "nuk mban në portofolin e saj rezerva ndërkombëtare në ar dhe metale të tjera të çmuara".

Turizmi në Kosovë, dimri sjell çdo vit rreth 100 mijë vizitorë nga Shqipëria

PRISHTINË, 6 SHKURT - Kosova njihet si vend me potencial të madh të zhvillimit të turizmit dhe resurseve që ka në dispozicion për turizëm dimëror. Ndonëse vendi ka pjesë atraktive për vizitorët e huaj, pandemia Covid-19 ka ndikuar në rënien e turistëve të huaj në mënyrë drastike.

Turistët nga Shqipëria vazhdojnë të jenë besnikë të Kosovës. Sipas të dhënave të Unionit të Turizmit (UTK), gjatë dimrit mbi 100 mijë shtetas nga Shqipëria vijnë në Kosovë dhe shpenzojnë rreth 20 milionë euro.

Kryetari i UTK-së, Baki Hoti, thotë se numri i turistëve që vizitojnë Kosovën nuk është i kënaqshëm. "Nëse bëjmë krahasime vitin 2020 me 2021 kemi një rritje të konsiderueshme për faktin se viti 2020 ishte gati plotësisht i mbyllur për shkak të masave që janë vendosur nga institucionet.

Por, në momentin kur ka pasur sadopak një lirim të masave, ka pasur fluks të vizitorëve jo vetëm nga Shqipëria, por edhe nga vendet e tjera. A është kjo e kënaqshme? Jo, nuk është por, si do që të jetë, në raport me vitin 2020 ka pasur lëvizje pozitive. Ndërkaq, nëse e krahasojmë vitin 2021 me vitin 2019, ka një rënie jashtëzakonisht të madhe, diku rreth 70 për qind ka rënie në raport me vitin 2019. Normalisht që edhe pandemia e bëri të veten jo vetëm në Kosovë, por në të gjitha vendet e botës", ka theksuar Hoti.

Përveç shteteve të tjera, vendi ynë ka turistë në numër të madh edhe nga Shqipëria.

Kryetari i Unionit të Turizmit të Shqipërisë, Rrahman Kasa, thotë se rreth 100 mijë turistë nga Shqipëria vizitojnë Kosovën gjatë sezonit të dimrit brenda një viti, të cilët, siç thotë ai, shpenzojnë rreth 20 milionë euro.



Andrea Aleks (1425-1505) prej Durrësit

NGA: LAZËR RADI (BOTUAR TE “BASHKIMI I KOMBIT”, NR. 183, 5 GUSHT 1944)

Pak vetë në Shqipëri e njohin Andrea Aleksin.

Në shtypin tonë kombëtar është folë pak ose aspak për këtë artist të madh të rilindjes Europiane. Vetëm “Hylli i Dritës” në numrin e vet të dhjetorit 1921, faqe 342, flet shkurtazi dhe ia bën të ditur lexuesit shqiptar emrin dhe një pjesë të veprës së këtij artisti të racës sonë. Mbi jetën dhe veprat e Andrea Aleksit kanë shkruar më shumë të huajt e në mënyrë të veçantë, sllavët të cilët e konsideronin si një artist të tyre të madh të Rilindjes. Ing. Jovan Adami që ka përkthyer në gjuhën shqipe “Historia e Durrësit” të Prof. K. Jeriçekut më dha nga dorëshkrimi i vet këtë shënim të vogël: “Magister Andrea Alexi de Durachio ndërtoi më 1447-1477 kisha dhe altare në Arve, në Tran (Trogir) goditja e kishës për pagëzim në Duomin) dhe në Spalato (Split).” Informatat për këtë i ka mbledhur Kukuljeviç në “Lexikon der Südslavischen Künstler”.

Mbi jetën e Andrea Aleksit dihen fare pak të dhëna. Por është e sigurt se u largua shumë i vogël nga Shqipëria dhe shkoi në Itali për të mësuar. Duket se do të ketë qenë shumë i varfër dhe se e mori nën kujdesin e vet për ta rritur dhe për ta shkolluar një bujar i përmendur i asaj kohe dhe pikërisht duka Françesk Sforza. Ky bujar nuk e ndau Andrean e vogël nga fëmijët e vet dhe duke parë prirjet dhe zgjuarsinë e tij, u kujdes dhe u interesua në mënyrë të veçantë për ta drejtuar në mësimin e shkencave dhe të arteve të bukura. Andrea Aleks i tregua një nxënës shumë i zellshëm dhe me prirje të mëdha artistike. Këto prirje Aleks erdhi duke i përsosur deri në at’ shkallë sa të fitojë një emër të madh për kohën e vet. Si në art ashtu edhe në drejtime të tjera Andrea Aleks i dallua në mënyrë të veçantë për punimet dhe veprat e veta pati një nderim dhe çmim të posaçëm në kohën e tij. Në Duomon e Milanos, vizituesi ndër sende të tjera mund të shikojë edhe një letër shumë të bukur kushtuar Zonjës së Ilirëve, të cilën shlanëzët e quajnë “Altare Albanese”. Në dy anët e këtij altari gjenden dy nënshkrime prej të cilave merret vesh se ky altar i bukur është bërë prej një farë Alexis de la Tarchetta de Albania capitaneo de la corte de barengo. Ky altar, gjithnjë simbas nënshkrimeve, u përfundua më 14 gusht 1480.

Gjithnjë duke analizuar mirë nënshkrimet e altarit të Zonjës së Ilirëve, vëmë re se këtë punim nuk e ka kryer me dorën e vet mjeshtër Andrea Aleks, por ka bërë që ta punojnë artistët e tjerë nën drejtimin e përpiktë dhe simbas projektit të punuar prej tij. Nënshkrimi thotë: “Questa opera a foto fare Alexio”. Megjithëse Andrea Aleks i në atë kohë ishte i zënë me detyra të ndryshme të rëndësishme dhe megjithëse nuk ka pasur kohë t’i kushtojë plotësisht kryerjes së këtij altari, megjithatë, një gojëdhënë dëshmon se pjesën më të madhe të punës e kreu me dorën e vet, por duke mos mundur ta kryejë vetëm, mori për ndihmë një mjeshtër tjetër të cilit i qëndroi mbi krye dhe e drejtoi në punë duke mos e lënë që t’i shmangej projektit të vizatuar prej tij. “Altare Albanese” është i lartë 4 metra dhe i gjerë 2 metra e gjysëm; është i punuar me një lloj mermeri të quajtur “Nero del Belgio”. Altari ka tri kupola dhe secila prej këtyre kupolave ka nga një shtatore: në të djathtë është truproja e quajtur Gjon Pagëzuesi, në mes truproja e një shenjtojeje që mban në dorë një pendë e një tub letrash. Altari është punuar prej mermeri të quajtur “Nero del Belgio”, kurse tre shtatorët janë të punuara prej mermeri “Carrara”.

Altari i Zonjës së Ilirëve, vepër e skulptorit shqiptar Andrea Aleks prej Durrësit, është pa dyshim një ndër punimet e tij më të mira. Altari stolisur me kapitela të shumta e të bukura. Në dy anët e këtij altari gjendet ky nënshkrim:

*Quando più sento in lii gran benefittii
chai a me fact o Vergene sancta et pura
in grandezza et honori et tutti offittii
tanto so più obligato a tua figura che d'Albania
Viuto piccoletto presso quel mio
Signore de' tanta altura
Duca Francesco Sforza io poviretto mallevai
primo et do lu fui exaltato per il mio ben
Servire in ogni effecto et da li suoi figlioli
sempre honorato io stato con gran mio vantaggio*

*sopra li meriti mei et del stato
per liqual doni io con fedel coraggio
o Vergine beata
anchor te prego quando fáro desta vita passagio
a la salute mia non facci nego per laqual çosa
ornato ho questa locho de l'immagine tua
ove io me lego a ux io debitare
benché sia pocho*

*Sa më shumë mendoj në ato mirësira të mëdha
Që mua më ke bërë o Virgjëreshë e shënjtë dhe e kulluar
Në madhështi e ndere e gjithë ofiqet
Kaq shumë tepër jam i detyruar në pamja jote
Se nga Shqipëria erdha vocërrak
Morra këtë zotërinë tim tepër të madhërishtëm
Dukën Françesko Sforca, unë i varfëri
Më rriti në fillim dhe prej tij u lavdërova
Për shërbimin tim të shquar në çdo drejtim
Dhe prej andej e bijtë e tij gjithmonë i nderuar
Unë kam qënë për të madhin fatin tim
Më shumë se meritat e fuqitë e mija
Për të cilat dhunti unë me kurajo besnike,
O Virgjëreshë e bekuar, akoma të lutem,
Kur do të zgjohem me kalimin e kësaj jete,
Shpirti im të mos mohohet
Për të cilin qëllim kam zbukurua këtë vend
Me imazhin tuaj unë mbetem i pandarë
Aleksi gjithmonë debitor, veç mos qoftë pak*

*Vergene sacra fonte de pietade
devotamente tutti ve preghamo
che per la Vostra infinita bontade
per noi interecetate ad quel dhe Adamo
quando pecco lui sant sficce in croce
del che ciaschun sempre de esser eramo
miserere gridando ad alta voce*

*Virgjëreshë e shënjtë burimplotë mëshire
devotshmërisht të gjithë të lutemi
se për të pafundmen tënde mirësi
Për ne u sakrifikove për atë që Adami
Sa mëkatoi, Ai u shpërblye mbi kryq
Që ç'do kush gjithmonë të jetë i mjerë
Fatkeqësisht bërtasin me zë të lartë.*

*Questa epoca a fato fare Alexio de la Tarchetta
de Albania capitaneo del la Corte de Barengo
nel anodet MCCCCLXXX di XIII del mese de agosto.*

*Këtë vepër bëri që të ngrihej Aleks i Tarketës
së Shqipërisë Kapiten i oborit të Arengo-s
në vitin e 1480-të të ditës 14 të muajt të gushtit.*

*Andrea Aleks, shqiptar prej origjine, i ka derdhë veprat
e veta anekënd detit Adriatik.*

Veprat e këtij artisti të madh janë parë në vende të ndryshme të Dalmacisë dhe pikërisht në Venedik, ishullin Rab, Zander, Llubonik, Troginë, Split, Jakinë dhe në Trenite. Mund të zbulohen edhe vende të tjera ndër të cilat Andrea Aleks ka derdhë veprat e veta, prej artisti të talentuar.

Ka punuar shumë duke filluar qysh në hyrje të shekullit XVI kur vdiq në Split. Në Kishën e Shpirtit të Shenjtë të këtij qyteti i ruhet edhe sot pllaka e varrit, të cilën e ka përgatitur dhe vendosur për vete qysh në vitin 1503.

Studenti Izedin Dizdari, që ka pas rastin t’i vizitojë këto vende, dhe t’i shohë vetë veprat e madhërishtë të skulptorit shqiptar Andrea Aleks, më dha disa shënime, të cilat po i botoj me shpresë për t’i plotësuar edhe me dokumenta të tjera.

Veprat më të vleshme të Aleksit ruhen në qytetin e Rilindjes, Trogir (Tran), qytet i vogël, por shumë i bukur në bregdetin dalmat. Ky qytet është një muzeum i vërtetë artistësh. Këtu Andrea Aleks, shkriu të gjithë fuqinë e zotësisë së vet. Do të mjaftonin veprat e tij të Trogirit, për t’u ngrit në shkallën e një artisti me vlerë të madhe.

Data e ardhjes së tij në Trogir nuk dihet me saktësi, por besohet të ketë ardhur aty rreth vitit 1466. Në këtë periudhë, pa ndihmën e kërkujt, punoi Batisterin dhe Pagëzimtoren e bukur dhe të madhërishtë në



Katedralen e Trogirit. Në ditën e fundit të atij viti, Aleks mori një shumë të konsiderueshme për veprën e vet që kreu gjatë vitit 1467, sepse në këtë vit është gdhendur emri i tij në majën e derës së Batisterit nga ana e brendshme. Edhe aktet e Arkivës së Trogirit e përmendin, më 20 janar, 14 shkurt, 1 qershor e 28 tetor të atij viti. Nga fundi i atij viti Andrea Aleks i njoh me një mjeshtër skulptor të dorës së parë. Ky ishte Nikollë Fjorentini, arkitekt i Katedrales së Shibenikut, të cilit historia e artit nuk ka mundur ende t’ia përcaktojë mbiemrin e vërtetë. Nëse përgjasimit e stilit nuk na gënjejnë, mjeshtër Nikolla ka qenë nxënës i Donatelos, bile ka qenë një nxënës shumë i zellshëm i tij. Ky erdhi në Trogir dhe në 19 dhjetor 1467, u caktua që të ndërtonte Kapelën e Shën Gjonit pranë Katedrales së qytetit. Për marrëveshjet kishte kërkuar që ta zëvendësonte bujari trogiras Korjolan Qipiko. Thuhet se pikërisht ky Qipiko kishte një kulturë të lartë dhe ishte i pajisur me frymën e Rilindjes; përveç kësaj kishte fituar nam në shërbim të Venedikut, për sa kohë që kishte komanduar një varkë në luftën kundër turqve. Trogirasit, të mrekulluar prej skulpturave të Andrea Aleksit në batiste, dëshirojshin që edhe një ipeshkvi e vjetër Gjon Orsini që kishte hyrë në rradhën e shejtanëve, për të ndërtuar një kapelë të veçantë pranë katedrales. Për këtë punim u bashkua Aleks me Fjorentinin dhe nënshkruan më 4 janar 1468, në të cilën Fjorentini zëvendësonte Qipikon, duke i premtuar drejtuesve të Kishës se do ta kryenin punën më së miri. Në të vërtetë kjo kapelë është edhe sot një ndër xhevahiret më të çmueshëm të artit të qytetit të Trogirit, njëkohësisht është edhe një ndër veprat më të bukura në të gjithë Dalmacinë.

Në kontratën e lidhur është e paraparë çdo hollësi punimi, por duke qenë se mungonin të hollat, artistët u detyruan të bënin disa ndryshime të vogla në pjesën e skulpturës. Punimet filluan në 1468 dhe njëri prej mjeshtërve mori si paradhënie shumë prej 70 dukatësh. Nga mungesa e të hollave ishin të detyruar të kërkonin edhe punime private. Për këtë arsye kanë punuar edhe në Kishën e Domenikanëve të Trogirit, një përmendore të Ivan Sabotiqit. Në Trogir është e ruajtur një seri e gjithë veprave artistike për të cilat dihet me siguri se i ka punuar firma Aleks-Fjorentini. Pallati ipeshkvi i Jak Torlanit i takon kësaj periudhe. Në këtë kohë u punua edhe pallati i pasur i Korjolan Qipikos, motivi i Bashës dhe i Merkaolandit u punua prej Aleksit sipas vizatimit të Gjergj Orsinit. Krishtin me dy engjëj e ka gdhendur Aleks, por ky punim nuk është futur në kishë dhe sot e kësaj dite qëndron në fushë të hapur për të luftuar me kohën.

Të shtrënguar nga varfëria mjeshtër tanë u detyruan të shkonin e të kërkonin punë edhe në vende të tjera. Duket se kanë shkuar me parë në Zadër (Zara) ku shihen edhe sot disa porta e më tepër dritare shumë të bukura që dëshmojnë se këta artistë kanë qenë për disa kohë në këtë qytet. Nga Zadri kanë shkuar në Split, ku kanë punuar këmbanoren e katedrales së qytetit. Kanë bërë edhe punime të tjera. Më 1473, kanë punuar edhe në Tremitet italiane dhe pikërisht kanë kryer faqatën e kishës së Shën Marias. Në Trogir u kthyen vetëm për një kohë të shkurtër. Sa kohë qëndroi Aleks në Trogir së bashku me shokun e vet Fjorentinin, është shënuar në 18 dokumenta të ndryshme, të cilat i zbuloi dhe i përmbodhi Dr. Pjetër Kolendiçi dhe i botoi në një vepër më vete.

Po të bëhen kërkime të tjera mund të nxjerrim njohur edhe më të gjera rreth jetës dhe veprave të këtij artisti të shquar shqiptar. Është detyra jonë, në mos tjetër, të fotografojmë punimet e vlefshme të këtij artisti, dhe t’ia bëjmë të njohur popullit shqiptar gjeninë artistike të racës sonë. /Radiandradi/

Sa i ka kushtuar botës pandemia?



**Nga Andrew SHENG &
Xiao GENG**
"Project Syndicate"

Ndërsa pandemia e Covid-19 hyri në vitin e saj të tretë, Shtetet e Bashkuara po përjetojnë një bum vazhdueshëm të bursave, ndërsa suficiti tregtar global i Kinës shënoi nivele rekord. Ka arsye të besohet se këto tendenca nuk do të zgjasin shumë.

Dhe kjo sepse Rezerva Federale e SHBA-së, është e vendosur ta shtrëngojë politikën monetare përballë inflacionit në rritje, ndërsa tregu i aksioneve të SHBA-së ka filluar të bjerë. Por edhe nëse rritja tregtare apo eksportet e fuqishme në ekonomitë më të mëdha të botës do të vazhdonin, shumica e njerëzve po përjetojnë vështirësi dhe ankth. Ne nuk duhet ta harrojmë këtë, e lëre më imperativin e ndryshimit sistematik.

Gjatë reagimit ndaj pandemisë, politikë-bërësit janë përballur me një dilemë të tmerrshme: ta mbajnë ekonominë të hapur, dhe të rrezikojnë më shumë vdekje nga COVID-19, ose të vendosin bllokime dhe të shkatërrojnë mjetet e jetesës. Siç e thekson ekonomisti i Universitetit Vanderbilt, W.Kip Viscusi, një mënyrë për të thjeshtuar shkëmbimin midis përfitimeve të reduktimit të rreziqeve shëndetësore dhe kosteve në ekonomi, është të "monetarizosh" vdekjet nga Covid-19.

Duke përdorur si njësi matëse Vlerën e një Jete Statistikore (VSL), Viscusi zbuloi se kostoja e vdekjeve nga Covid-19 në

gjysmën e parë të 2020-ës, arriti në 1.4 trilion dollarë në SHBA dhe 3.5 trilion dollarë në nivel global. Edhe pse SHBA-ja përbënte 25 për qind të numrit të vdekjeve, pjesa e saj në koston globale të vdekshmërisë ishte 41 për qind, pasi vendet më të pasura kanë një VSL më të lartë. Jeta e një amerikani vlerësohet në aspektin e produktivitetit që i jep ekonomisë në 11 milionë dollarë, dhe e një afgani vetëm 370.700 dollarë. Nëse dikush bën të njëjtën llogari për vdekjet e raportuara zyrtarisht deri në fundin e vitit 2021 – që janë gjithsej rreth 5.6 milionë – kostoja e vdekshmërisë do të ishte 38 trilionë dollarë, ose 40 për qind e PBB-së globale.

Nga ana tjetër, nëse bazohemi në vlerësimet e "The Economist" për shifrën e vërtetë të vdekjeve nga pandemia – afër 17 milionë – atëherë dëmi rritet në 114 trilionë dollarë, ose 120 për qind e PBB-së. Kina iu qas shumë ndryshe nga SHBA-ja dilemës që solli pandemia, duke zgjedhur të mbronte jetët e njerëzve nëpërmjet bllokimeve të rrepta, madje edhe në kurriz të zhvendosjeve më të mëdha ekonomike.

Në rast se Kina do të kishte të njëjtën shkallë infektimesh si SHBA-ja, dhe të njëjtën shkallë vdekshmërie (pak më shumë se 2.9 për qind), vdekjet totale të saj nga Covid-19 do të kishin arritur në 4.1 milion, në vend të 4.849 që ka regjistruar zyrtarisht.

Një VSL e Kinës prej 2.75 milionë dollarësh për person, nënkupton se kjo do të kishte nënkuptuar një humbje shtesë prej 11.3 trilionë dollarësh, ose 67 për qind të PBB-së deri në vitin 2021. Duke pasur parasysh faktin që ekonomia e

Kinës ka ecur relativisht mirë gjatë pandemisë, pavarësisht bllokimeve, duket e drejtë të arrihet në përfundimin se qasja e Kinës çoi në kosto më të ulëta të përgjithshme.

Në çdo rast, kostot aktuale të pandemisë së Covid-19 janë më të larta se sa tregojnë rezultatet e VSL. Duke bërë bashkë vdekshmërinë, sëmundshmërinë, problemet e shëndetit mendor dhe humbjet e drejtpërdrejta ekonomike, ish-Sekretari i Thesarit i SHBA-së, Larry Summers dhe ekonomisti i Universitetit të Harvardit, David M.Cutler vlerësojnë se SHBA-ja pësoi një humbje prej 16 trilionë dollarësh, ose sa 90 për qind e PBB-së, vetëm në vitin 2020.

Pavarësisht këtyre kostove të larta, dilema me të cilën përballet një vend si SHBA apo Kina, është më pak e vështirë sesa ajo me të cilën përballet ekonomitë më të varfra në zhvillim. Me borxhe të mëdha dhe me një aftësi të kufizuar për të marrë hua, qeveritë e këtyre vendeve kanë pasur pak mundësi për të rimëkëmbur ekonomitë e tyre. Mungesa e vaksinave dhe sistemet e dobëta shëndetësore, i kanë bërë ato edhe më të prekshme.

Fondi Monetar Ndërkombëtar paralajmëroi kohët e fundit se për shkak të pandemisë, të ardhurat në 40 shtete të brishta dhe të prekura nga konflikti, po bien edhe më tej. Dhe nuk është e vështirë të kuptosh arsyet: këtyre vendeve u mungojnë kapacitetet apo burimet institucionale për të menaxhuar apo zbutur në mënyrë efektive rreziqet sociale, ekonomike, politike, të sigurisë dhe ato mjedisore.

Tashmë, dhuna është në nivelin më të lartë të 30 viteve të fundit

në nivel global. Shtetet e brishta – ku banojnë gati 1 miliardë njerëz – mund të përbëjnë 60 për qind të të varfërve në botë deri në vitin 2030. E gjithë kjo po e dëmton ekonominë globale.

Raporti i fundit i raportit të Bankës Botërore për Perspektivat Ekonomike Globale, parashikon se rritja globale do të ngadalësohet nga 5.5 për qind në vitin 2021 në 4.1 për qind në vitin 2022 dhe 3.2 për qind në vitin 2023.

Pas këtij parashikimi janë kërcënimet që vijnë nga variantet e reja të Covid-19, rritja e inflacionit, borxhi në rritje, pabarazia në rritje dhe sfida shqetësuese të sigurisë. Ekonomistët si Viscusi, Summers dhe stafi i FMN-së dhe Bankës Botërore, analizojnë opsionet e politikave dhe pasojat e tyre në terma të kostove monetare ose PBB-së.

Por dilema me të cilën ballafaqohen politikë-bërësit është në thelb morale, e rrënjësuar jo vetëm tek pyetja se kur preferencat individuale duhet të mbizotërojnë mbi interesat kolektive. Pavarësisht nga saktësia e dukshme e llogaritjeve kosto-përfitim, pandemia është tek e fundit një sfidë sistematike që është e ndërlikuar me të tjerat, nga pabarazia te ndryshimet klimatike.

Dhe nuk ka zgjidhje të thjeshta. Siç argumentoi së fundmi Minouche Shafik, drejtori i Shkollës së Ekonomisë dhe Shkencave Politike në Londër, pandemia e ka bërë të qartë nevojën për një kontratë të re sociale të përshtatshme për sfidat bashkëkohore.

Kontrata e vjetër shoqërore i kishte rrënjët në Kodin e

Dominimit, i mishëruar në Zanafillën 1:26, kur Zoti tha: "Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës tonë, sipas ngjashmërisë tonë, për të sunduar mbi peshqit e detit dhe zogjtë e qiellit, mbi bagëtinë dhe mbi të gjithë Tokën dhe çdo krijesë që zvarritet mbi të".

E megjithatë, jo të gjithë njerëzve iu dha i njëjti autoritet. Në vitin 1493, Doktrina e Zbulesës e Kishës Katolike u dha të krishterëve të drejtë për të skllavëruar jo të krishterët, dhe për të marrë pronën e tyre. Kjo doktrinë pati jehonë në SHBA edhe në vitin 1823, kur Gjykata e Lartë vendosi se shteti kishte më shumë të drejta sesa njerëzit indigjenë.

Siç tregojnë antropologu i ndjerë David Graeber dhe kolegu i tij David Wengrow, idetë e lirisë dhe barazisë që udhëhoqën Iluminizmin Evropian, u formësuan nga kontakti i parë i evropianëve me indianët e Amerikës së Veriut.

Kontrata sociale që na nevojitet, duhet të pasqyrojë forcat dhe vlerat që i japin formë botës në të cilën jetojmë sot, përfshirë ndërlikohet e thella midis ekonomive dhe shoqërive tona, vlerën e qenësishme të të gjithë njerëzve, dhe sfidën e përbashkët ekzistenciale të ndryshimit të klimës. Sot, zgjedhja nuk është të dominosh apo të dominohesh; por të punojmë së bashku ose të shfarosemi së bashku.

Shënim: Andrew Sheng, anëtar i Institutit Global të Azisë në Universitetin e Hong Kongut.

Xiao Geng, kreu i Institucionit të Hong Kongut për Financat Ndërkombëtare.

Mashtruesi që shpiku një shtet



Gregor MacGregor lindi në Skoci më 1786 dhe vdiq në Venezuelë më 1845. Ishte ushtar aventurier dhe mashtrues i madh. E shpiku shtetin Poyais, një vend në Amerikën Qendrore që nuk ekzistonte, por që e shpalli veten për sundimtar të tij. Në vitin 1822, në Londër, MacGregor arriti të bindte qindra njerëz për ta kaluar Oqeanin e për të shkuar në Poyais, duke shkaktuar vdekjen e shumicës së tyre. Sot konsiderohet si “Mbreti i Mashtruesve”, njeriu që arriti të krijojë gënjeshtren më të madhe të krijuar ndonjëherë. Ishte djali i një kapiteni detar të Kompanisë britanike të Indisë Lindore, i cili u rrit duke folur galeishten skoceze. Më vonë mësoi anglisht në shkollë.

MacGregor ka pretenduar se ka studiuar për disa kohë në Universitetin e Edinburgut, por në lidhje me këtë nuk ka asnjë dëshmi. E, duke pasur

parasysh karakterin e tij, është e lehtë të dyshosh në të. Dihet me siguri, që në moshën 16-vjeçare, pak para se të fillonin Luftërat Napoleonike, u regjistrua në Ushtrinë britanike. U martua me Maria Bowaterin, vajzën e një admirali të pasur dhe gjithashtu falë parave dhe famës së familjes së saj, bëri një karrierë të shpejtë ushtarake. MacGregor u bë kapiten në një kohë shumë të shkurtër dhe më pas gjeneral. Pas disa vitesh në Gjibraltari, la ushtrinë më 1810 dhe u kthye në Mbretërinë e Bashkuar. Sidoqoftë, më 1811, vdekja e gruas së tij ia ndryshoi perspektivën e jetës. Pa paratë dhe pa mbështetjen e familjes së saj, u detyrua që në vitin 1812 të nisej për në Venezuelë, në kohën kur po zhvillohej një revoltë kundër spanjollëve. Atje u martua me një kushërirë të revolucionarit Simon Bolivar dhe përsëri bëri karrierë

ushtarake – këtë herë në radhët e ushtrisë së Republikës së Venezuelës. Shënoi disa suksese dhe u bë i njohur si themeluesi i Republikës së Floridës e cila zgjati vetëm disa muaj.

Në verën e vitit 1821, një dekadë apo më shumë pas largimit të tij, u kthye në Mbretërinë e Bashkuar. Iu bashkua edhe bashkëshortja e cila kishte mbërritur nga Amerika e Jugut në Evropë. Tha se ishte kthyer në Londër për të marrë pjesë në kurorëzimin e mbretit George IV, në emër të shtetit Poyais. Kishte prodhuar dokumente të ndryshme, monedha, stemë dhe një flamur. Madje, arriti të shkruajë edhe një libër për atë vend të largët të nënshkruar me pseudonimin Thomas Strangeways.

Duket absurde, por ndoshta nga frika se do të humbnin investimin e duhur apo thjesht u mashtruan nga disa premtime, shumë njerëz

arritën të blinin bonot e shpikura nga MacGregor. Referuar vlerësimeve të bëra nga “The Economist”, mendohet se bonot, të gjitha së bashku, kapin vlerën e katër miliardë eurove. Shumë nga personat që u mashtruan ishin skocezë.

Teksa interesi për vendin imagjinar rritej, MacGregor rriti çmimet dhe filloi të shesë tokë. Madje përfundoi duke organizuar udhëtime në Poyais. Arriti të mbushë dy anije prej 250 personash që u nisën në shtator të 1822 dhe në janar të 1823. Udhëtimi zgjati dy muaj. Ata që pretendonin se do të gjenin Poyaisin, fatkeqësisht nuk gjetën asgjë. Shumë vdiqën nga uria ose nga malaria, por disa falë edhe kontakteve me popullsinë vendase dhe mbështetjes së anijeve që kalonin, arritën të largoheshin. Shumë vdiqën rrugës në kthim, të tjerë u ndalën në vende të ndryshme

të Amerikës, por vetëm rreth pesëdhjetë njerëz arritën të ktheheshin në Mbretërinë e Bashkuar.

“Ishte e qartë se kishin jetuar në kushte ekstreme dhe dukeshin si fantazma dhe kufoma”, shkruante një gazetë skoceze e kohës.

Lajmi se shteti Poyais nuk ekzistonte u përhap me shpejtësi, duke ndihmuar kështu në anulimin e nisjes së anijeve të tjera, lajm ky që detyroi MacGregorin të arratisej në Paris, nga ku u përpoq përsëri të shiste idenë e Poyaisit, por me shumë pak sukses.

U arrestua në Francë. Në një gjyq të zhvilluar më vonë u shpall i pafajshëm. MacGregor u kthye në Skoci dhe përsëri u mundua të përfshihej në disa mashtrime që kishin lidhje me Poyaisin. Më 1838 u largua për në Karakas, ku u mirëprit përsëri si qytetar venezuelian. Vdiq atje në vitin 1845. /TCh/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Fitore e lehtë për Yllin, 'Bardhekaltrit' mposhtin 'Vreshtarët'

PRISHTINË, 6 SHKURT - Golden Eagle Ylli ka mundur Dritën me rezultat 65:100 (20:24, 17:24, 11:30, 17:22), në takimin që u zhvillua në Therandë, në kuadër të javës së 19-të në Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll. Në çerekun e parë kishte më shumë rivalitet, ku epërsia më e lartë u takoi therandasve 14:22, ndërsa kjo pjesë përfundoi 20:24. Gjilanasit rezistuan deri në fund të pjesës së parë, kur kampionët shkëputen me 11 pikë epërsi, për të shkuar në pushim me shifrat 37:48. Në pjesën e dytë nuk kishte histori, ku liderët dominuan liderët dhe shënuan fitore të thellë dhe të merituar. Periodën e tretë e fituan

bindshëm 11:30 dhe atë të fundit 17:22, për të triumfuar në fund me shifrat 65:100. Te Drita u dalluan Laurant Ibrahimimi me 21 pikë dhe Isaiah Johnson me 14 pikë, kurse te Golden Eagle Ylli u dalluan me 22 pikë e tetë kërcime, Aj Sumbry me 13 pikë e 16 kërcime dhe Ardit Pepaj me 21 pikë. Drita ka 19 humbje në 19 ndeshje, kurse Golden Eagle Ylli ka 15 fitore e katër humbje. Sigal Prishtina ka shënuar fitore ndaj Rahovecit me rezultat 67:53 (15:18, 23:14, 16:11, 13:10), në kuadër të javës së 19-të në Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll. Çereku i parë ishte mjaft i baraspeshuar, ku epërsia më e lartë u takoi mysafirëve, gjashtë pikë, 8:14, derisa kjo pjesë

përfundoi 15:18. Por, prishtinasit rikthehen shpejt në periudhën e dytë, duke pasur epërsi deri në tetë pikë, 35:27, dhe më pas u zhvillua lojë e barabartë, duke shkuar në pushim me shifrat 38:32. Vendasit vazhduan me lojë të mirë edhe në periodën e tretë, duke thelluar edhe më shumë epërsinë, që shkoi në 14 pikë, 38:24, ku më pas kryesisht u zhvillua lojë e barabartë, ndërsa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 54:43. Në dhjetë minutat e fundit, kryeqytetasit menaxhuan lojë, duke ruajtur epërsinë, dhe triumfuan me shifrat 67:53. Sigal Prishtina ka dhjetë fitore e nëntë humbje, kurse Rahoveci ka gjashtë fitore e 12 humbje.



Favoritët kalojnë në çerekfinale të Kupës

PRISHTINË, 6 SHKURT - Janë mësuar edhe tri skuadra tjera çerekfinaliste të Kupës së Kosovës. Drita, Ballkani dhe Prishtina kanë kaluar tutje, pasi në ndeshjet e sotme të 1/8 së finale kanë realizuar fitore. Drita ka arritur fitore me rezultat bindës ndaj skuadrës së Ligës së Parë, Fushë Kosovës, me rezultat 5:0, në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin e Ramiz Sadikut në kryeqytet. Serinë e golave e hapi Ardian Cuculi, në minutën e 27-të nga penalltia. Edhe golin e dytë skuadra gjilanasë e shënoi nga pika e bardhë, por kësaj here realizator ishte Arbnor Muja, në minutën e 42-të. Pak para pushimit epërsinë në 3:0 e shtoi Marko Simonovski, derisa Almir Ajzeraj dhe Arbnor Muja shënuan nga një gol në pjesën e dytë, në minutat 62 e 69 për rezultatin përfundimtar 5:0. E fitore shumë më të vështirë realizoi Ballkani në duel me Malishevën në Suharekë, me rezultat 1:0. Golin e kualifikimit për skuadrën e drejtuar nga Ilir Daja e realizoi Albion Rrahmani, në minutën e 79-të, pak minuta pas inkuadrimin në lojë. Ndërkaq, Prishtina kaloi



tutje vetëm pas vazhdimëve duke e mundur Drenicën, 2:1, ngase ndeshja në kohën e rregullt u mbyll 1:1. Të parët në epërsi kaluan kuqezinjët me golin e Kreshnik Ukës, në minutën e 61-të, derisa shifrat i barazoi Besnik Krasniqi, në minutën e katërt të shtesës nga penalltia. Në vazhdimë bardhekaltrit e kryeqytetit e gjetën shpejt golin, kur Sadam Sulley shënoi vetëm pas dy minutash, duke ia siguruar

kësisoj biletën për çerekfinale. Gjilani ka kaluar në çerekfinale të kësaj gare, ngase në shtëpi e ka mundur Dukagjinin, me rezultat 2:1, në një duel mjaft interesant dhe me ritëm të lartë. Golat për Gjilanin i shënuan Gerhard Progni, në minutën e 23-të dhe Elton Cale, në minutën e 90-të, teksa golin e barazimit të përkohshëm mysafirët e shënuan nëpërmjet autogolit të Arbër Prekazit, në minutën e 38-të. Mjaft

interesante ishte edhe ndeshja ndërmjet Onixit dhe KEK-ut, e ku fituesi u përcaktua vetëm pas penalltive. Ndeshja në kohën e rregullt dhe pas vazhdimëve u mbyll, 3:3, derisa në serinë e penalltive më të mirë u treguan futbollistët e Onixit, të cilët triumfuan 5:4. E vazhdimet e përcaktuan fituesin në ndeshjen Ulpiana-Arbëria (2:1), derisa Ramiz Sadiku u tregua bindës në duel me 2 Korrikun, duke fituar 6:1.

Muriqi shënon golin e parë në La Liga

Mallorca, 6 shkurt - Sulmuesi i Kombëtares së Kosovës, Vedat Muriqi ka realizuar golin e tij të parë në La Liga. Ai, në paraqitjen e dytë me Mallorcan, pas huazimit nga Lazio në afatin kalimtar, ka shënuar golin e fitores në duel me Cadizin, me rezultat 2-1. Ylli dardan u tregua i saktë nga penalltia, në minutën e 66-të, derisa pati paraqitje të mirë gjatë 89 minutave sa qëndroi në fushën e gjelbër. Kjo fitore ia mundësoi Mallorcas të ngjitet në pozitën e 17-të me 23 pikë.



Rashani ia siguron fitoren Clermontit

NICE, 6 SHKURT - Sulmuesi anësor i Kombëtares së Kosovës, Elbasan Rashani ka gjetur sërish rrugën e golit në kampionatin francez, Ligue

1. Rashani ka shënuar golin e fitores për skuadrën e tij Clermont në udhëtim kundër Nices (1:0). Ylli dardan shënoi në minutën e

77-të të ndeshjes nga afërsia, duke regjistruar kësisoj golin e tij të pestë në këtë edicion në Ligue 1, por të parin në vitin 2022. Ai luajti titullar në

këtë ndeshje deri në minutën e 85-të. Pas kësaj fitoreje, skuadra e tij Clermont renditet në vendin e 15-të, me 24 pikë.





Në pajtim me nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Paneli për përzgjedhjen e anëtarit joekzekutiv të Bordit të BQK-së, publikon:

Shpallje

Për plotësimin e një (1) pozite të anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Profili i kërkuar:

- Person me integritet dhe përgatitje universitare;
- Minimum dhjetë (10) vite përvojë profesionale ose akademike në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitet apo çështje juridike;
- Njohuri në krijimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të rëndësishme të lidhura me misionin, objektivat dhe detyrat e BQK-së;
- Në mënyrë specifike të plotësojnë kushtet sipas nenit 40 të Ligjit nr. 03/L-209 për BQK-ën;
- Njohja e gjuhës angleze paraqet përparësi.

Emërimi do të jetë për një mandat pesëvjeçar duke filluar nga data e emërimit.

Lista e kandidatëve që kualifikohen nga ana e Panelit do t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili do të përzgjedh një individ. Miratimi dhe emërimi për këtë pozitë do të bëhet nga Presidenti i Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 84 paragrafi 27, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 38 paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-209 për BQK-ën.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë një CV me detaje dhe një letër motivuese përmes email adresës vijuese: paneli@bqk-kos.org ose në dorë në zarf të mbyllur në arkivin e BQK-së, Rruga Garibaldi nr. 33 në Prishtinë, ose përmes postës në adresë të BQK-së: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (shënim: për pozitën e anëtarit joekzekutiv të Bordit të BQK-së), Rruga Garibaldi nr. 33, 10000 Prishtinë, Kosovë.

Afati për aplikim është deri më 7 mars 2022, në orën 16:00.

Vetëm kandidatët e të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit do të thirren për intervistë.



U skladu sa članom 38 Zakona br. 03/L-209 o Centralnoj banci Republike Kosovo (CBK), Panel za izbor neizvršnog člana Odbora CBK, objavljuje:

Oglas

Za popunjavanje jedne (1) pozicije neizvršnog člana Odbora Centralne banke Republike Kosovo

Traženi profil:

- Lice sa integritetom i univerzitetskom spremom;
- Najmanje deset (10) godina profesionalnog ili akademskog iskustva u oblastima ekonomije, finansija, bankarstva, računovodstva ili pravnih pitanja;
- Znanje za kreiranje i praćenje sprovođenja važnih politika u vezi sa misijom, ciljevima i zadacima CBK-a;
- Da ispunjava na specifičan način uslove iz člana 40 Zakona br. 03/L-209 o CBK;
- Poznavanje engleskog jezika je prednost.

Imenovanje ima mandat od pet godina sa početkom od dana imenovanja.

Lista kandidata koji su kvalifikovani od strane Panela biće dostavljena Skupštini Republike Kosovo, koja će izabrati jednog pojedinca. Odobrenje i imenovanje za ovu poziciju izvršiće predsednik Republike Kosovo u skladu sa članom 84, stav 27 Ustava Republike Kosovo i članom 38, stav 2, Zakona br. 03/L-209 o CBK.

Zainteresovani kandidati treba da dostave CV sa detaljima i motivaciono pismo na sledeću e-mail adresu: paneli@bqk-kos.org ili lično u zatvorenoj koverti u arhivi CBK, Ul. Garibaldi br. 33 u Prishtini, ili poštom na adresu CBK-a: Centralna banka Republike Kosovo (napomena: za poziciju neizvršnog člana Odbora CBK-a), Ul. Garibaldi br. 33, 10000 Prishtina, Kosovo.

Zadnji rok za apliciranje je 7. mart 2022. godine, do 16:00. časova.



**MILLENNIUM
FOUNDATION
KOSOVO**

SPECIFIC PROCUREMENT NOTICE (SPN)

Country	Kosovo
Project Name	Threshold Program
Procurement Title	Contract for the Construction of Apartment Building Efficiency Retrofits (AER) – Prishtina
Procurement Ref. Number	RFQ /2022/005
Type of Procurement (goods, works or services as applicable)	Works
Employer	Millennium Foundation of Kosovo (MFK)
Publication Date	04 February 2022
Submission Deadline	28 February 2022; 14:00 pm (Kosovo Time)

The Millennium Foundation Kosovo has received financing from the Millennium Challenge Corporation toward the cost of the “Threshold Program agreement”, and intends to apply part of the proceeds toward payments under the contract for the Contract for the Construction of Apartment Building Efficiency Retrofits (AER) – Prishtina.

MCC’s funding is appropriated by the U.S. Congress and obligated to the threshold up-front, with no incremental or partial funding. So, when a contract is signed with an MCA Entity, money is already available to the MCA Entity and, for most contracts, invoices are paid directly to Contractors/Consultants/Suppliers by the US Treasury.

MFK now *bids* from eligible *bidders* for the Works Requirements.

Bidding will be conducted through the *Shopping* procedures as specified in the MCC Program Procurement Guidelines (PPG), and is open to all eligible bidders or consultants as defined in the PPG.

A complete set of Request for Quotation (RFQ) documents including any clarifications, notices and/or addendums may be obtained by interested eligible bidders through the following website (Eventual clarifications or any changes to the RFQ document shall be published at the latest 3 days before the submission deadline on the link provided below):

<https://millenniumkosovo.org/procurement/procurement-of-contract-for-the-construction-of-apartment-building-efficiency-retrofits-aer-prishtina-2022-005>

A **pre-Bid conference** shall take place at the **10 February 2021, at 14:00** (Kosovo Time), through Zoom meeting link: <https://us02web.zoom.us/j/86718366791>

Bidders interested in submitting bids should register their interest by sending a completed registration, with the reference and subject of the RFQ to the Procurement manager at procurement@millenniumkosovo.org, giving full contact details of the bidder.

Please note that only electronic applications submitted via the File Request Link (dropbox link) shall be accepted. Submissions by hard copy or by email are not acceptable and shall culminate in bids rejection. The File link for submission of bids is included in the RFQ document.

Bids shall be submitted **ONLY** to the file request link provided in RFQ documents no later than **28 February 2022 at 14:00 (Kosovo Time)**. Only electronic submission will be permitted. Late applications will be rejected.

Contact Information:

The address(es) referred to above is (are):	Str. “Migjeni” no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
Attn:	Arton Çitaku MFK Procurement Manager Str. “Migjeni” no. 21 (ex-Bank of Ljubljana, floor IX), Postal Code:10000 Prishtina, Kosovo
Tel:	00 383 38 752 110
E-mail:	procurement@millenniumkosovo.org
Website:	https://millenniumkosovo.org



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues